



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
AGENCIJA ZA SPREÇAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPREÇAVANJE KORUPCIJE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dok. Nr. Prot. 371/26	
Dok. Br. Prot. 05	
Dok. Nr. Page	Data 16.03.2026



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 13.03.2026, nxjerrë këtë:

### V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. prot. DPKI-2074/25, për Vjollca Vorfaj, zyrtare në Policinë e Kosovës-NJRHKEK në Gjakovë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren policore Vjollca Vorfaj në Policinë e Kosovës-NJRHKEK në Gjakovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/1-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të kërkesës nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë pjesë relevante nga kërkesa): “[...] Unë jam pronar i njësisë Kadastrale P-..., Zona Kadastrale Gjakovë-Qytet, në sipërfaqe prej 162 m<sup>2</sup>, pjesa e pronës 1/1. Për këtë pronë zyrtarja policore znj. Vjollca Vorfaj është duke bërë hetime, të udhëhequr me nr. te rastit DHEKE/P/..., të cila për mendimin time janë tendencioze, për arsye si më poshtë.

Zyrtarja policore Vjollca Vorfaj është e përfshirë personalisht dhe ka kontest në një çështje tjetër pronësore për pronën time, konkretisht në pasurinë 0-....., me sipërfaqe 52 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Gjakovë-J. Qytet, ajo vepron si person i autorizuar i zonjës Z.V., e cila ka ngritur padi kundër ish pronares së kësaj banese për vërtetim pronësor dhe ka ushtruar veprime për ta regjistruar banesën time në emër të znj. Z.V, duke qenë e njëjta e imja.

*Autorizimi për këtë paluajtshmëri i zonjës Vorfaj, është noterizuar tek noteri A.S., me LRP. Nr.7665/2019, me çka kësaj kërkesë ja bashkëngjis si shtesë. Për të njëjtën pronë, unë kam pasur autorizim të vlefshëm, ndërsa aktualisht ajo është e regjistruar ne emirin tim sipas certifikatës pronësore zyrtare, me çka kësaj kërkesë ja bashkëngjis si shtesë autorizimin tim dhe certifikatën e pronës, si dhe padinë e ushtruar ndaj ish pronares ku edhe sot është duke u zhvilluar kontesti për vërtetim pronësie.*

*Duke qenë se Vjollca Vorfaj ka interes të drejtpërdrejt dhe marrëdhënie pronësore të lidhura me mua si palë që ka kontest të hapur civil, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, i cili është duke u zhvilluar më numrin C.nr.565/20, ekziston konflikt i qartë interesi dhe pamundësi për ushtrimin e paanshëm të funksionit zyrtar gjatë hetimeve në pronën tjetër të time.*

*Hetimet që ajo po ndërmerr lidhur me dokumentacionin e pronës P-..., janë tendencioze, të orientuara për ta dëmtuar apo frikësuar, ndonëse i gjithë dokumentacioni i pronës është i rregullt dhe i vërtetuar në organet shtetërore.*

*Duke qenë se zyrtarja policore është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt në një çështje civile me mua, dhe me tepër, duke e ushtruar detyrën e saj në të njëjtën njësi policore që po heton rastin tim, ekziston rrezik real që çdo veprim hetimor i ndërmarr praj saj të ndikoj në perceptimin e paanshmërisë së organit hetimor, gjë që bie ndesh me neni 5 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 2 të Ligjit për Policinë, të cilët kërkojnë që çdo veprim policor të jetë objektin dhe i paanshëm[...].”*

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ lidhur pretendimet e ngritura për konflikt të interesit.

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të kësaj situatë, Agjencia përmes shkresës zyrtare (DPKI-230/26), ka kërkuar nga Drejtoria për Hetime të Brendshme në Policinë e Kosovës, informacion/dokumentacion, se nëse ndaj Vjollca Vorfaj zyrtare policore, është zhvilluar procedurë disiplinore sipas njoftimit nga Inspektoratit Policor i Kosovës. Nëse po, të na informoj lidhur me rezultatin apo epilogun e kësaj çështje.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtoria për Hetime të Brendshme në Policinë e Kosovës ka ofruar informacion dhe dokumentacion, duke sqaruar se Drejtoria e Hetimeve të Brendshme ka zhvilluar procedurë disiplinore në çështjen në fjalë dhe pas përfundimit të procedurës disiplinore, ka nxjerrë vendim duke i pushuar hetimet.

Agjencia ka shqyrtuar, analizuar dhe administruar provat relevante që lidhen me vërtetimin e fakteve/pretendimeve për konflikt të interesit të ngritura nga raportuesi i rastit, informacionin dhe dokumentacionin në dispozicion, të gjitha këto në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me datë 22.07.2019, me nr. LRP.nr. 7665/2019, Z.V. ka dhënë autorizim me të cilin ka autorizuar Vjollca Vorfaj që ta përfaqësojë atë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, K.K. Gjakovë, Stacionin Policorë në Gjakovë, Zyrën Kadastrale Komunale në Gjakovë, Drejtorinë për Urbanizëm në Gjakovë, Zyrën Noteriale, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të Jashtme në Republikën e Kosovës, në të gjitha Ministrinë e Republikës së Kosovës, në Prokuroritë e Republikës së Kosovës si dhe çdo organ lokal, qendrorë apo privat të Republikës e Kosovës, për dorëzim, tërheqje dhe nënshkrim të çdo lloj dokumenti. Po ashtu, përmes këtij

autorizim i është dhënë e drejta që ta përfaqësoj Z.V. për rregullimin e dokumenteve të nevojshme për banesë nr. 1387, kati: përdhese me sip. 52.10 m<sup>2</sup>;

Më datë 25.07.2019, Z.V. ka dhënë autorizim me të cilin e ka autorizuar avokatin Ilir Hoxha për të kryer në emër dhe për llogari të saj të gjitha veprimet e nevojshme para institucioneve të Republikës së Kosovës;

Me datë 13.09.2018, me nr. LRP.nr. 5134/2018, F.N.G. ka dhënë autorizim, me të cilin ka autorizuar Albehar Fejzën që të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për blerjen nga AKP-ja të banesës, në bazë të kontratës mbi shfrytëzimin e banesës së lëshuar nga BVI;

Me datë 13.10.2025, Prokuroria Themelore në Gjakovë/Departamenti për Krime të Renda, Prokurori i Shteti, ka nxjerr Aktvendimin me nr. PPN/I.142/25, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paraqitur nga Albehar Fejza Gjakovë, për përjashtimin nga hetimi i rastit në këtë prokurori të Vjollca Vorfaj zyrtare policore në Policinë e Kosovës-NJRHKEK në Gjakovë. Nga përmbajtja e arsytimit të këtij aktvendimi rezulton se: *Nuk plotësohen asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 44 paragrafi 1 të KPPRK-së për përjashtimin e pjesëmarrësve tjerë në procedurën penale, sepse zyrtarja policore nuk është palë dhe as përfaqësues e autorizuar në kontestin juridik civil pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër C.nr.565/20, ngase sipas shkresave të kësaj lënde civile konkretisht padisë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë datë 17.08.2020 dhe Aktvendimit C.nr.565/20 datë 18.08.2020 rezulton të jetë avokati I.H.;*

Me datë 17.10.2025, përmes Njoftimit 03-116-2497, Inspektorati Policor i Kosovës e ka informuar Albehar Fejza, se ankesa është trajtuar dhe analizuar nga Departamenti i Menaxhimit të Ankesave, me ç'rast pas trajtimit është konstatuar se nuk përmban element penale që të trajtohet në IPK. Në përputhje me Ligjin e IPK-së nr.03/L-231, me datë 17.10.2025, e njëjta është dërguar në Policinë e Kosovës, konkretisht në Drejtorin për Hetim të Brendshme për hetim të mëtutjeshëm disiplinor, nën dyshimin se zyrtari policor mund të ketë kryer shkelje disiplinore;

Po ashtu, me datë 02.12.2025, Drejtoria e Hetimeve të Brendshme-Policia Kosovës, ka marrë vendimin me numër të lëndës: 0597-PK-2025, më të cilin pushohet procedura disiplinore ndaj punonjësës së Policisë së Kosovës, Vjollca Vorfaj, që punon në NJRHKEK-Gjakovë, për shkak se gjatë hetimeve nuk janë gjetur elemente të shkeljeve disiplinore. Nga arsytimi i këtij vendimit rezulton se: *Pretendimet e ankuesit nuk kanë mundur të dëshmojnë sepse punonjësja e policisë asnjëherë më parë nuk e kishte shfrytëzuar autorizimin që posedon për banesën në kontest, kjo pasi që për një gjë të tillë ishte i autorizuar dhe ngarkuar avokati I.H., ngase në kontest siç ceket më lartë janë qytetarja Z.V. dhe F.G., e jo në këtë rast ankuesi.*

Më pas, më qëllim të sqarimit plotë të rastit, Agjencia ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga avokati Ilir Hoxha lidhur me atë nëse në kontestin juridiko-civil që zhvillohet pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, me nr. C.nr.565/20, ai ushtron cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar së palës Z.V. nga Gjakova, si dhe, nëse po, nga cila datë ka ndërmarrë veprime juridike dhe/ose procedurale në këtë kontest gjyqësorë. Sipas informacioneve të pranuar rezulton se nga datë 25.07.2019 avokati Ilir Hoxha është autorizuar nga shtetasja Z.V. nga Gjakova për përfaqësimin e saj, me ç' rast ka paraqitur kërkesën administrative pranë Drejtorisë për Kadastër. Më pas me datë 17.08.2020, ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, në kontestin juridiko civil që është duke u zhvilluar

ende, duke theksuar se gjithherë ka qenë i autorizuar në përfaqësim të te drejtave të shtetases Z.V.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të mundshëm të interesit, pas administrimit të provave dhe informacionit në dispozicion, në vështrim të gjendjes faktit si më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konstatoi si në dispozitiv të këtij vendim, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit, për zyrtaren policore Vjollca Vorfaj, për faktin se në kontestin juridik civil, i cili është duke u zhvilluar pran Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër C.nr.565/20, palën Z.V. e përfaqëson avokati Ilir Hoxha në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar, në bazë të autorizimit të datës 25.07.2019, ndërsa zyrtarja policore Vjollca Vorfaj nuk rezulton të jetë përfaqësuese e autorizuar në këtë procedurë, përkundër pretendimeve të raportuesit të rastit.

Situata e konfliktit të interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen dhe/apo çastet paraprake të vendimmarrjes* lidhur me ekzistencën e *interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm* në një çështje të caktuar, e që lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur ndonjë element përmbajtjesor të konfliktit të interesit.

Në këto rrethana, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vlerëson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e domosdoshme kumulative për ekzistimin e konfliktit të interesit, respektivisht nuk është konstatuar ekzistimi i interesit privat të zyrtares apo të personave të afërm të saj që do të mund të ndikonte në ushtrimin e paanshëm dhe të drejtë të detyrës zyrtare. Fakte këto të bazuara edhe në arsyetimet e vendimeve të institucionit të Prokurorisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës, si fakte që arsyetojnë gjendjen dhe rrethanat lidhur me këtë rast.

Sa i përket pretendimeve tjera të ngritura nga raportuesi i rastit, të cilat pretendime nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit, përkatësisht janë jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk janë trajtuar gjatë kësaj procedure.

**II.** Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtares policore Vjollca Vorfaj
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Raportuesit të rastit Albehar Fejza

